



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

**NGA SHKOLLA E VIZATIMIT TEK INSTITUTI I ARTEVE FIGURATIVE
(NJË HISTORI E SHKURTËR E NDËRTIMIT TË INSTITUCIONEVE ARTISTIKE NË
VEND)**

Ermir Hoxha

Abstrakt

Rrugëtimi i insitucioneve artistike në Shqipërinë e shekullit të XX, ishte një eksperiencë dinamike e një lloji të veçantë. Kuptimi i saj nis fillimisht me vendosjen e saj në kontekst kohor, fillimisht në Shqipërinë ende pjesë e Perandorisë Osmane, e më pas me përpjekjet për insitucione të mirfillta, në strukturën e brishtë të monarkisë shqiptare. Kështu mes Shkollës së Artit dhe Zanateve të Saverio Polarollit, Shkollës së Vizatimit e më pas Liceut artistik dhe Institutit të Artit Figurativ, duket se nuk kemi pasur një stafetë domosdoshmërisht lineare. Më shumë se kjo, duket se ky tranzicion multiform është thjesht shkak pasojë e dinamikave politike e kulturore që shoqëruan vendin në gjithë fazën e vet të ngritjes institucionale.

Fjalët kyç: *Art, Institucione, Shkolla e Vizatimit, Liceu artistik, Instituti i Lartë i Arteve,*

1. Shoqëria “Miqte e artit” dhe Shkolla e Vizatimit

Në kapërcim të shekullit XIX-XX arti pamor ishte një medium aq i panjohur sa dhe vetë profesioni i piktorit.¹ I përqëndruar në qytete, në pak profesionistë/amatorë ai më shumë kuptohej si zgjatim i zantçinjve me aftësi të veçanta estetike, se sa me një profesion derivat i një shkollimi të mirëfilltë. Në fakt, në këto dekada artistë të paktë si italiani Pietro Marubbi (1834-1903), apo ai shkodran Kolë Idromeno (1860-1939) mund të përkufizohen më saktë si profesionist/zanatçi të gjithëdijshëm. Ata realizojnë pak vepra arti, për tu angazhuar më shumë si fotograf, piktorë, apo arkitekt e inxhinjer, edhe pse Marubbi ishte diplomuar për pikturë në lice, ndërsa Idromeno ishte bartës i një eksperience të shkurtër në Akademinë e Arteve në Venecia. Si të tillë ata thjesht përshtaten me një treg pothuaj pa konkurrencë në cilindo prej këtyre profesioneve, (në fillim si piktor e më pas si fotograf) sipas kërkesave të klientelës. Si e tillë vepra e tyre duhet kuptuar më shumë se e motivuar nga frymëzimi, nga një motor i mirëfilltë kërkesash të një borgjezie të vogël tregëtare në rritje, e cila kërkonte një imazh të ri modern si për vete dhe për qytetin ku jetonin.

Po në këtë realitet ekzistonin edhe hapsira ku mund të mësohej arti. E para mes tyre daton në Shkodër, nën emrin “Scuola d’Arte e Mestieri” drejtuar nga italiani Saverio Polarolli. Një nga nxënësit e Idromenos, Simon Rrota, (1887-1961) mbi të kujton se: “Duhet me dijtë se kjo shkollë industriale

¹ Një shembull të kësaj, e ofron piktori anglez Edward Lear, i cili teksa skiconte në Shqipërinë e viteve 1848 – 49 kujton si rrebeshin e tmerrshëm të gurëve në Shqipërinë e Mesme, aq dhe këshillat teknike të oficerëve turq në qytetin e Janinës. Shih Edward Lear, *Edward Lear në Shqipëri, Ditar udhëtimesh, 1848-1849*, (Tiranë: Plejad, 2008), 76 dhe 253.

ishte e ndame ndër tri degë: mekanike, zdrukhtari e daltë (intaglio) dhe seksioni i pikturës. Edukatorët e kësaj shkolle kanë kenë; Gioacchino Perlin për mekanikë, Angelini për zdrukhtari, Peppino Tommasini për daltë. Për seksionin e pikturës ishte vetë drejtori Saverio Polaroli.”²

Mbi vetë Polarollin ai shton se: “... jo vetëm ishte administrator me përvojë por edhe piktor i mirë. Kur pau punimet e mija, u gëzue shumë tue më pvetë se ku kisha mësue deri atëherë? E unë u përgjigja se vetëm mbas dishirit tem e simbas udhëzimeve qi më kishte dhanë Kolë Idromeno. Mbasi pau edhe njëherë të gjithë punimet e tue kuptue dishirin tem të madh për pikturë, më tha me vazhdue mësimet aty në atë shkollë, mbasi materiali ishte i mjaftueshëm.”³

Me gjithë këto përpjekje, në tërësi kuptimi i artit dhe artistit duhen kuptuar në vlerën e vet të vërtetë. Mjaft të sjellim në vëmendje eksperiencën tronditëse po të Rrotës, i cili vetëm pak vite më parë kujton se sa i pakuptuar ishte ende profesioni i artistit, kur rrugëve të qytetit: “...shkrue njerëz... me kryet në gershanë”. Sipas tij ky fenomen përbënte një skandal të madh, aq sa burrat e mëhallës të frikësuar shpesh i hakërreheshin se do e padisnin në gjykatë, “pse për shkakun e tij, gratë kishin frigë me dalë jashtë pse ai i vizatojshe”.⁴

Deri në fillim të viteve ‘30-të, të shekullit të kaluar pak të rinj me prirje artistike kishin marrë mësimet e para në studiot e artistëve të qyteteve të tyre ose sipas mundësive, kishin frekuentuar institucionet e mesme apo të larta të vendeve fqinje. Në rang lokal, tentativa institucionale artistike kishte ndër-marrë në qytetin e Shkodrës e sipërcituara e Saverio Polarollit, ndërsa ka informacione dhe për një kurs vizatimi të organizuar nga piktori korçar Spiro Xega në qytetin e tij, ashtu siç përmendet dhe një “Shkollë e Arteve të Bukura”, drejtuar nga avokati Duro Guri, në qytetin e Gjirokastrës.⁵

Institucionalizimi kombëtar i veprimtarisë artistike do të merrte formë më të plotë vetëm në 10 maj 1931 me krijimin e shoqërisë “Miqte e Artit” nga Odhise Paskali e Qenan Meserea. Me statut e program të mirëfilltë, ajo u mbështet menjëherë nga një grup i ri artistësh si Vangjush Mio, Zef Kolombi, Abdurrahim Buza e Lasgush Poradeci si dhe nga brezi më i vjetër i artistëve si Idromeno e Xega. Kjo shoqëri artistike, e para e këtij lloji, u krijua nën moton “...për qëllim zhvillimin e artit përgjithësisht, në të gjitha shfaqjet e veta”, ndërsa u përgëzua dhe nga shtypi i kohës si një iniciativë e papritur, por e suksesshme. Formimi i saj ishte sintezë e dëshirës së shumë intelektualëve që nga konteksti lokal duhet të propozoheshin si një frymë e re në rang kombëtar. Me krijimin e kësaj shoqërie merr fund dhe karakteri rajonal, që karakterizonte artin shqiptar deri në atë kohë, ndërsa Tirana do krijonte kushtet për lulëzimin e një atmosfere intelektuale e progresiste.

Dy javë pas krijimit, më 24 maj 1931, shoqëria “Miqte e Artit” realizon të parën ekspozitë kombëtare. E organizuar në ambientet e kafesë “Kursal”, në të morën pjesë 15 artistët më në zë të kohës, si K. Idromeno, O. Paskali V. Mio, Z. Kolombi, S. Rrota, N. Martini, S. Xega, e Q. Meserea.

Në të njëjtin muaj (maj 1931) që Shoqëria “Miqte e artit”, hapte të parën ekspozitë kombëtare, në Tiranë u hap dhe Kursi i Vizatimit, i pari i këtij lloji, drejtuar fillimisht nga piktori Andrea Kushi e financuar nga Enti Kombëtar dhe Komiteti i Arteve. Ngjarja u prit me entuziazëm të madh. Që në ditët e para, pas përzgjedhjes, u regjistruan rreth 150 djem e vajza. Dyndja tregoi qartë për domosdoshmërinë e ngritjes së një institucioni më të madh. Pas rreth një viti, në janar të vitit 1932, u themelua Shkolla e Vizatimit, nën drejtimin e profesorit italian Mario Ridola. Në shtypin e ditës artistët shprehnin pa rezerva pritshmëritë e tyre se tashmë arti ishte futur në rrugë të mbarë. Paskali theksonte

2 Simon Rrota, *Po shkruaj për vedi e Shkodrën*, (Shkodër: Botime Fishta, 2018), 91.

3 Po aty, 89.

4 Po aty, 30-31.

5 Duro Guri, avokat, (e më pas kryetar i gjykatës së Tiranës) piktor amator e qëndistat në Gjirokastrë përmendet në shtypin e kohës në vitet 1914- 1920 për realizimin e disa tablove dhe qëndismash.

se: “Drita e Oksidentit filloi t’i çelë syt’ e përgjumur, po organet janë të dobsuara nga errësira shekullore e së shkuarës. Ushtrim e kohë nga ana jonë dhe brezi që rritet do të shtjerë mjaft shigjeta t’arta kundrejt qiellit t’onë të lirë.”⁶ Mbyllja e vitit të parë shkollor u shoqërua me hapjen e një ekspozite me punimet e nxënësve, shoqëruar kjo dhe me punime nga artistët e afirmuar. Dhe kjo ekspozitë u shoqërua me komente entuziaste nga shtypi i kohës, pasi në të merrnin pjesë studentë e profesorë, si dhe vetë drejtori i shkollës, M. Ridola, me disa tablo me temë shqiptare.⁷ Pas kësaj kurse të tjera vizatimi, u hapën nëpër prefektura të rretheve dhe studentëve më premtues iu akreditohehin bursa studimi.⁸

Me kalimin e viteve, do të vërehej një rritje në numër e nxënësve dhe e mësuesve, deri sa kjo shkollë arriti të konsolidohej si vendi ku do të ngriheshin brezat më të mirë të artit të së ardhmes. Tematikat lëviznin nga ato klasike akademike, si modelet, portretet e natyrat e qeta, deri tek peizazhet dhe skenat nga jeta qytetare. Vetë drejtori i Shkollës së Vizatimit e orientoi drejtimin artistik të saj drejt akademizmit, kur solli modele në gips nga antikiteti klasik, ndërsa modelet e klasave ishin djem, vajza e pleq kryesisht veshur me kostume kombëtare, një aspekt që po zhdukej para syve të artistëve nën vazhden e modernizimit të shoqërisë.

Gjithashtu në vitet 1932-33, po në Tiranë, në Institutin Teknik “Harry T. Fultz”, nën drejtimin e Zef Dajçit⁹ u hap kursi apo klasa e dekoracionit. Ky kurs ishte i ndarë në dy drejtime, në klasën e vizatimit dhe të skulpturës dhe funksiononte me programe teknike dhe artistike. Në të mësohej fillimisht të vizatonin me proporcione, me hije drite dhe me volume, si dhe të modelonin në argjilë modele të rumbullakëta e në relieve. Në një fazë të dytë nxënësit mësonin prodhimin e objekteve artistike, kapituleve, pllakave me dekorime floreale, gjeometrike, etj. Përfundimisht, nxënësi formohej si një zejtar apo zanatçi, ku përfshiheshin të gjitha punët artistike në derdhjen e allçisë. Në këto kurse, prej 4 apo 8 vitesh, morën mësimet e para disa emra të afirmuar artistësh si Ibrahim Kodra e Andrea Mano.

2. Liceu Artistik

Pasluftës, në entuziazmin e viteve të para, atmosfera e përgjithshme ishte deri diku më liberale, pasojë kryesisht e influencës së Sejfulla Malëshovës, ministër kulture dhe një nga intelektualët më në zë të kohës. Nën ndikimin e tij në vitin 1945, formohet Lidhja e parë e Shkrimtarëve Shqiptarë¹⁰, (LSHSH) si dhe revista “Bota e Re”, e cila e pa dritën e botimit deri në vitin 1946. Pas vitit 1946, tendenca e kontrollit të sferave artistike, sidomos në fushën e letrave filloi gradualisht të vihej nën kontrollin

6 Odise Paskali, “Varfëria kreative e brezit të ri”, *Illyria*, nr. 3, 18 mars (1934).

7 Ekspozita u inaugurua në 5 qershor 1932 në godinën e madhe të Shkollës së Vizatimit. Shtypi i kohës informon se: “Në këtë ekspozitë qenë dërguar këto vepra: Prof. M. Ridola 16 copë piktura, de Marshis 4, Q. Meserea 57, V. Mio 29, Meli 17, Andrea Thanas 15, Ysref Frashëri 9, Th. Nushi 11, Todi Delta 3, P. Nigro 3, Zallahi 3, Vladimir Papajani 3, Th. D. Duka 3, F. Makoçi 3, Elena Dilo 2, G. Topallaj 2, C. Mima 7, Nikolla Lako 3, Kostaq Stefa 1, Sh. Toptani 1... Çmimet fillonin që prej 20 deri më 2000 fr. ar copa.” Për më shumë mund të shihet “Inaugurimi i ekspozitës së artit”, *Gazeta e Korçës*, 8 qershor, (1932): 4., ndërsa punime të përzgjedhura nga Shkolla e Vizatimit mund të shihen N. V. “Akademia e jonë e arthme e arteve të bukure”, *Minerva*, nr. 12-13, korrik – gusht, (1933): 18., ose Nebil Çika, “Një djep i jetës artistike në Shqipëri”, *Minerva*, nr. 10, 15 maj, (1933): 12-14.

8 Informacion të detajuar mbi funksionimin e Shkollës së Vizatimit ofron artikulli “Shkolla përgatitore për artet e bukura”, *Besa*, 1 dhjetor (1932): 3.

9 Zef Simon Dajçi, 1890-1963, lindi në Shkodër, ku kreu dhe studimet e para në shkollën “Per Arti Mestieri”, e më pas kreu një specializim 3 mujor në Milano për arte dekorative. Nga punimet më të mira të tij njihet Shën Françesku i Asizit, realizuar në allçi e vendosur në fasadën kryesore të Kuvendit të Motrave Stigmatine në Shkodër. Vepra mbijetoi gjer në vitin 1967. Mund të shihet Lec Zadeja, “Zef Dajçi, mjeshtër i shquar i daltës e i allçisë”, *Shkodra në shekuj*, Seminar Ndërkombëtar, Vëllimi i II, (1999): 411.

10 LSHSH, formuar në tetor 1945, u formua nga shkrimtarë të prirjeve e botëkuptimeve të ndryshme, siç ishin V. Prenushi, S. Malëshova, A. Xhuvani, A. Asllani, S. Luarasi, L. Poradeci, Dh. Pasko, S. Shpuza, S. Spasse, Dh. Shuteriqi, e Sh. Musaraj.

shtetëror¹¹. Dy vjet më vonë (1948), nga strukturat shtetërore kërkohej shprehimisht që në aktivitetet artistike të mos aktivizoheshin njerëz nga klasat e vjetra, por ato të zëvendësoheshin me elementë me prejardhje punëtore e fshatare. Në vazhden e kësaj politike, nisën të vinin dhe specialistët e parë sovjetikë, për të ndihmuar kolegët shqiptarë e për të formuluar më qartë kërkesat që letërsia e arti duhej të ndiqte. Gjatë gjithë kësaj periudhe, artet drejtoheshin nga Ministria e Shtypit, Propagandës dhe e Kulturës, për të kaluar më pas në varësinë e Ministrisë së Arsimit.¹²

Nuk vonuan as investimet në artin pamor. Ekspozita e parë daton në prill 1945, me pjesëmarrjen e 23 artistëve me 111 punime.¹³ E prezantuar si ekspozita e parë e Rendit të ri, ajo tregon më së miri për aspiratën që kishte shteti i ri për një klimë artistike dinamike, nevojën për pasqyrimin e “viteve të lavdishme” të luftës dhe orientimin tematik që do formulohej më mirë në vitet në vazhdim.

Përveç ekspozitave që do të ndiqnin njëra-tjetrën, vëmendje e veçantë iu dedikua dhe institucioneve artistike arsimore. Liceu Artistik “Jordan Misja” u inaugurua në nëntor të vitit 1946, me 12 nxënës dhe 4 pedagogë, me degët e pikturës, skulpturës dhe dekoracionit. Me mësues të shkolluar në disa nga akademitë më të mira perëndimore, nxënës të saj kujtojnë se ajo ishte një shkollë serioze, me një entuziazëm të dukshëm, mësues të pasionuar dhe pa ndikime politike. Mbi këtë shkollë, Vilson Kilica kujton: “Mua m’u duk një shkollë serioze, sipas kujtimeve të mia të rinisë, sepse aty kishte pedagogë që kishin studiuar në perëndim, kryesisht në Itali. Ishte Sadik Kaceli, Nexhmedin Zajmi, Odhise Paskali, Kristina Hoshi, Abdurrahim Buza, etj. Këta ishin mësues të apasionuar, të cilët përfaqësonin një erë të re. Në atë kohë, ata ishin të interesuar që arti të lulëzonte.” Edhe Edi Hila, nxënës i kësaj shkolle në fundin e viteve ‘50, kujton se liceu i atyre viteve ende nuk ishte përfshirë nga ndikime politike: “E para përçohej atmosfera, mjaft entuziaste. Nuk ishte një fenomen i rastit, por një fenomen që shoqëron të gjitha shoqëritë, ku psikologjikisht përjeton kohën dhe idenë e gjithçkaje që po rifillon dhe do shkohet përpara. Kjo është një ndjenjë shumë e bukur për ta përjetuar. Për hatër të kësaj kategorie profesorësh nuk ndihej shumë në të politizimi.”¹⁴

Paralelisht nisën në kohë rekord ndërtimi i një sërë qendrash kulturore, grupet e para artistike me aktorë e muzikantë; shkolla e parë artistike, me dy profile, muzikë dhe arte figurative si dhe një sërë organesh të reja shtypi (deri në vitin 1948 ishin hapur 25 të tilla). Kjo reformë e madhe kulturore me qëllim edukimin dhe zbavitjen e masave, vazhdoi më tej me ngritjen e një zinxhiri bibliotekash (numri i tyre në vitin 1948 arriti në 373) në të gjithë vendin; një sërë teatros, Pinakoteka (1954), Filarmonia e Shtetit (1950), Estrada e Tiranës (1952) dhe po atë vit Kinostudio “Shqipëria e Re”. Deri në fundin e viteve ‘40, me insistimin e ethshëm të shtetit, kishte përfunduar faza e krijimit të strukturave artistike profesioniste, struktura në të cilat u hodhën bazat e ardhshme të artit shqiptar edhe pse brenda tyre kishte të përzier amatorë, të pasionuar e artistë profesionistë.

3. Kthimi i studentëve nga shkollat lindore dhe Instituti i Lartë i Arteve

11 Një pjesë e intelektualëve në zë si J. Vroni, A. Pipa, M. Kuteli, P. Marko, etj. ishin arrestuar, ndërsa revista “Bota e re” ishte “zëvendësuar” nga “Literatura jonë”, ku përfshiheshin ata shkrimtarë që përkrahnin vijën e re ideologjike. Kjo do të ishte vala e dytë e terrorit kundër intelektualëve. E para kish nisur që në ditët e para të çlirimit, kur një valë arrestimesh (65) e pushkatimesh (28) përshkoi gjithë vendin.

12 Enver Hoxha në vitin 1946 kishte deklaruar se: “Populli ynë ka nevojë për më shumë bukë, por ka nevojë gjithash-tu për më shumë kulturë dhe arsim...” Enver Hoxha, *Mbi letërsinë dhe artet*, (Tiranë: 1977).

13 Andon Kuqali na informon se: “Shumë punime kishin temë e përmbajtje të rëndomtë: peizazhe, natyra të qeta, figura me kostume popullore. Por nuk mungonte edhe pasqyrimi i luftës në aspekte të ndryshme, buste e piktura të një partizani, të një partizaneje, vizatime që tregonin për luftën dhe jetën partizane ose paraqitnin fatkeqësitë që kishte shkaktuar armiku: refugjatë, portrete fëmijësh jetimë, peizazhe vendesh të rrënuara.” Andon Kuqali, *Historia e Artit Shqiptar* 2, 1989, 77.

14 Shkëputur nga një intervistë audio-vizive marrë me V. Kilicën dhe E. Hilën (arkiv i autorit).

“Metoda e Realizmit Socialist”, term i hasur rëndom në çdo artikull të botuar në vitet ’50, kish përftuar një fizionomi të improvizuar, që në vitet e para të pasluftës. Pjesa më e madhe e artistëve u njoh me të nëpërmjet ilustrimeve të revistave sovjetike, udhëtimeve që bënë në BS, apo ekspozitat e pakta që u sollën në Tiranë. Të çorientuar, ata improvizuan mbi shembujt e veprave që pëlqeheshin në konkurse, ato që lakoheshin në debatet e shumta në shtypin e kohës, apo “kopjuan” deri diku shembujt klasikë të artit sovjetik.

Edhe pse të qartë mbi direktivat shtetërore, vështirësitë që ata hasën për materializimin e kësaj metode, qenë serioze. Shteti shqiptar, i vetëdijshëm për këtë, si dhe si pasojë e mungesës së specialistëve në shumë fusha të artit, (dhe të shkencës) kërkoi me ngulm edukimin e një brezi të zgjedhur nxënësish, të cilët do dërgoheshin për studimet e larta në vendet e Bllokut Lindor¹⁵. Në një dekadë, rreth 4500 prej tyre, përzgjedhur sa nga cilësia, aq dhe nga shtresa shoqërore e biografia¹⁶, u dërguan si misionarë në vendin “nënë” të komunizmit proletar dhe në vendet e tjera satelitë të saj. Në optikën shtetërore, ata do të përbënin një arsenal besnik, sa për implementimin e socializmit në vend, aq dhe për materializimin e duhur të ideologjisë shtetërore.

Grupet e para të të diplomuarve në arte nisën të ktheheshin aty nga gjysma e dytë e viteve ’50, ndërsa pak prej tyre të detyruar nga ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike, u diplomuan në Institutin e Arteve Figurative në Tiranë. Artistë si Sali Shijaku, Kristaq Rama, Jakup Keraj, Guri Madhi, Zef Shoshi, Vilson Kilica, Kujtim Buza, Agim Zajmi, Llambi Blido, Rafael Dembo, Mumtaz Dhrami, Shaban Hadëri e Thanas Papa studiuan në BS, ndërsa Thoma Thomai, Hektor Dule, Ksenofon Dilo, Halim Beqiraj e Llazar Myzeqari në Pragë; Hysen Devolli, Perikli Çuli, Spiro Kristo e Isuf Sulovari në Bukuresht; Danish Jukniu e Shaban Hysa në Varshavë; Abdulla Cangonji në Sofje e Aristotel Papa në Zagreb.

Impakti i tyre personal dhe institucional, edhe pse për një periudhë të shkurtër kohore, rezultoi i suksesshëm. Kristaq Rama nga periudha e studimeve kujton se: “Në akademi, studentët shqiptarë kishin emër mjaft të mirë, sidomos piktorët... Vitin që erdhi Z. Shoshi, profesori e pyeti nga ç’vend ishte dhe kur Zefi iu përgjigj se ishte shqiptar, ai i thotë: “Oh, me siguri talent”! Dhe nuk ia pa punën fare. Kujtonte se nga Shqipëria do të dërgoheshin gjithmonë talente si Saliu e Guri. Ndërsa mbi formën dhe strukturën e studimeve Kilica kujton se: “Në programin e kësaj shkolle ishin programet artistike, që zinin pjesën dërrmuese të orëve të studimit, qoftë gjatë ditës dhe gjatë vitit. Kishim ciklin e lëndëve teorike-profesionale, por që lidheshin me pikturën, skulpturën, vizatimin, pastaj ishte grupi i lëndëve të formimit të përgjithshëm siç ishte estetika dhe filozofia marksiste-leniniste, historia e PK së BS-së. Unë vetë kam bërë pikturë, vizatim, dhe kompozim, që quheshin tre lëndët bazë profesionale. Të tjerat pastaj, ato teoriket ishin anatomia, perspektiva dhe historia e artit, botërore dhe ruse.”¹⁷

Shumë nga punimet e realizuara gjatë viteve të studimit, ruhen ende sot në familjet e tyre. Në to dallohen kërkimi i imët anatomik, hetimi psikologjik i personazhit dhe vendosja e tij në hapësirë, si forma klasike e ndërtimit akademik. Dëshmi të tjera nga vitet e shkollimit janë dhe një sërë portretesh realiste, ku veçohen ato me “ngjyra orientale” të gjetura rëndom mbi modelet që vetë shkolla ofronte.

15 Në fakt, domosdoshmëria e edukimit me arsim të lartë të kuadrove, vihet në dukje që në vitet e para të pasluftës. Që në vitin 1946, raporti i agjentit rus P. I. Macha që mbulonte Shqipërinë, evidenton se: “P.K.SH ka 12000 anëtarëqë niveli i shkollimit është i ulët... 78 % kanë shkollë fillore 26 % janë fshatarë të varfër dhe gati 23.7 % janë gati më mirë, ndërsa ata me shkollë të lartë janë shumë të rrallë”, në Genti Gjikota, *Architectural stalinist typologies in albania – The palace of Culture and Cine-studio “New Albania”*. (Ma... Bartlett School of Architecture, University College, London, 2009-2012), 29.

16 Vilson Kilica mbi këtë argument thekson se: “Zgjedhja e tyre mund të thuhet se ishte e kombinuar, ishte dhe talenti dhe biografia,.. ishin të dyja bashkë.” Intervistën dhënë në nëntor të vitit 2010, arkivi personal i autorit.

17 Shkëputur nga Suzana Varvarica Kuka, *Kristaq Rama – Monografi*, (Tiranë: Zenit edition, 2004),16,..” Citim i shkëputur nga intervista me V. Kilicën. Arkiv personal i autorit.

Ndryshimet e pakta mes tyre, vihen re si pasojë e multiformitetit akademik, kulturor e gjeografik, por dhe talentit e kërkimit personal të studentit.

Mbi veçantitë e Realizmit socialist, studentët shqiptarë kujtojnë që edhe gjatë shkollës nuk vihej re një ndikim i madh nga stafi pedagogjik për përzgjedhjen e njërës apo tjetrës temë. Njohja me të vinte sa nga lëndët teorike aq dhe nga informacioni që merrnin në rrugë të tjera, ekspozita, konkurse me çmime, artikuj gazetash e revistash. Ndërsa si gjuhë stilistike e estetike, realizmi padyshim që mbetej orientimi parësor për çdo student sidomos në shkollat e BS-së. Dëshmi e kësaj janë dhe diplomat e studentëve shqiptar, të cilët realizmit standard i mbivendosën dhe tematikat tipike shqiptare. Guri Madhi, realizoi një tablo që merrte temë nga lufta e Bajram Currit; Vilson Kilica “Të papunët” shqiptarë të viteve të paraluftës; Jakup Keraj një vështrim historik mbi kohën e Skënderbeut; Thanas Papa një ekuestër të heroit kombëtar,¹⁸ ndërsa Andrea Mano e Kristaq Rama, sollën stereotipa shqiptarë me veshjet tradicionale.

Në optikën e shtetit totalitar, investimi i dërgimit të studentëve në vendet e lindjes ishte bërë, që ata të mund të kristalizojnë e implementojnë fizionominë e vërtetë të metodës së Realizmit Socialist, si dhe pikat ku ai mbështetej. Të rikthyer, ata duhej të ushtronin detyrën e nënkuptuar dhe t’i jepnin jetë një arti për masat, funksional e pa “gabime e imitime të huaja”.

Në ato vite të para larg Bllokut Lindor, disa prej tyre, kontributin e tyre e orientuan në plotësimin e boshllëqeve institucionale, siç ishte p.sh. ngritja e institucioneve të larta arsimore për artin. Siç kujton iniciatori i saj Vilson Kilica: “Ideja më lindi mua, e më pas e bisedova dhe me Kristaq Ramën, i cili sapo qe kthyer e më pas më zëvendësoi mua në ministri. Fati im ishte që këtë ide e bisedova me zv. Ministrin P. Mitroqorgji, i cili ishte njeri shumë i apasionuar. Ai më inkurajoi të paraqisja një relacion. U konsultova dhe me Kristaqin, e me nja dy shokë të tjerë. Më pas relacioni u çua në instancat shtetërore, të cilët e mbështetën, pasi rruga ishte hapur nga shkolla për aktorë. Pak më vonë u hap dhe konservatori, e pak a shumë po ndërtohej forma që ka sot Akademia e Arteve. Në fund të ’59 doli vendimi që të hapej Instituti, fillimisht 3 vjeçar. Më 4 janar të 1960 u çel Instituti i Arteve Figurative, ndërsa bashkimi i këtyre 3 degëve është bërë në vitin 1966.”¹⁹

Kështu, në 4 janar të vitit 1960 u inaugurua Instituti i Arteve Figurative, institucion që do të shërbente si bërthama e të mëvonshmit Institut i Artit të Arteve (e tashmë i vetmi institucion ku çdo artist vendas do diplomohet). Fillimisht, tre vjeçar, vetëm në dy degë, pikturë e skulpturë, instituti huazoi programe të thjeshtuara të shkollës sovjetike, ndërsa pedagogët e saj të parë, do të ishin po produkt i këtij investimi. Nëse në Liceun Artistik në fillimin e viteve ’60 akoma një pjesë e mirë e pedagogëve ishin ish-studentë të Akademive Perëndimore, (Kaceli, Zajmi, Buza, Kodheli etj.) në Institutin e Artit, supremacia e ideologjisë lindore ishte e dukshme. Kështu, Instituti u hap dhe u drejtua nga ish-studentë të vendeve të lindjes, si Vilson Kilica, Sali Shijaku, Kristaq Rama, Guri Madhi, Shaban Hadëri, Danish Jukniu, Hektor Dule, Perikli Çuli etj. Në optikën shtetërore, këta pedagogë edhe pse më të rinj (Kilica, drejtori i parë ishte vetëm 28 vjeç), ishin pajisur me strukturën ideologjike dhe mjetet e duhura formale, për orientimin e qartë të çdo studenti drejt fizionomisë së Realizmit Socialist.

Në vitin 1961, si pasojë e prishjes së marrëdhënieve diplomatike me BS-në, të gjithë studentët shqip-

18 Sipas autorit Thanas Papa, diploma e tij u vlerësua me Medalje Ari, një vlerësim që kishte 10 vjet që nuk akordohej. Pas kësaj vepra do derdhej në allçi në dy kopje. E para do të ekspozohej në Moskë në Ekspozitën e Vendeve Socialiste, e më pas do ruhej në fondin e shkollës, ndërsa e dyta do ti dërgohej për dhuratë shtetit shqiptar. Kopja e dytë do të vendoset në shkollën ushtarake “Skënderbej” me kërkesë të piktorit Fatmir Haxhiu, ku me kalimin e viteve do të pësonte dëmtime serioze. Nga një bashkëbisedim me autorin. Arkiv personal i autorit. Mund të shihet dhe Albert Xholi, “Thanas Papa: Drama me ish-gruan ruse pas 32-vitesh”, parë më 12 dhjetor 2014 në http://www.zemrashqiptare.net/news/id_29248/Thanas-Papa:-Drama-me-ish-gruan-ruse-pas-32-vitesh.html

19 Siç kujton Kilica: “Më 4 janar të 1960 u çel Instituti i Arteve Figurative, nën drejtimin e tij, ndërsa bashkimi i këtyre 3 degëve është bërë në vitin 1966”. Intervistë audiovizive me V. Kilicën, (arkivi i autorit).

tarë u detyruan të kthehen në Atdhe. Shteti duhej të merrte masa për të mbijetuar nga ndarja me BS-në, ndërsa dekadat që do të pasonin, do tregonin që insistimi i shtetit mbi supremacinë stilistike e estetike të brezit të shkolluar në lindje, do të krijonte atë që quhet Realizmi Socialist Shqiptar.

4. Ndryshimet strukturore të ILA në vitet '60

Sistemi katërvjeçar do të niste që prej vitit 1965. Një vit më vonë do të realizohej bashkimi i tre shkollave të larta të artit: Konservatori Shtetëror i Tiranës, Instituti i Lartë i Arteve Figurative dhe Shkolla e Lartë të Aktorëve "Aleksandër Moisiu". Kështu në vitin 1966 u inagurua Instituti i Lartë i Arteve (IAL), emërtim që do ta mbante deri në vitin 1990. Drejtor i parë i ILA do të zgjidhej Vilson Kilica.

Ndryshimet strukturore që do pasonin institucionin e Artit Pamor kishin të bënin me formatin e saj didaktik, përqasjen ndaj mediumeve dhe përshtatjen me zhvillimin industrial të vendit. Ato nisën në vitin 1969 me vendosjen e drejtuesit të fakultetit të Artit Figurativ, piktorit Ksenofon Dilo, i cili kish studiuar në Pragë në një shkollë arti të stilit Bauhaus. Siç kujton ai vetë: "Unë doja të ndryshoja karakterin e kësaj shkolle që ishte e tipit rus, e përqëndruar vetëm në pikturë e skulpturë. Unë mendova që të shtoheshin të gjithë këto degët (Tekstili, Moda, Tantella, piktura monumentale, Qeramika, Xhami e Qelqi) dhe filluam bashkë me Danish Jukniun, i cili ishte ftuar nga Vilsoni pak para meje, për tekstin, që ishte hapur pak para se të vija unë në vitin 1968. Danish kishte bërë një shkollë të stilit Bauhaus, e kështu bashkarisht vendosëm të bënim ndryshimet e para."²⁰

Kështu strukturës së parë përqëndruar në mediumet e pikturës dhe skulpturës do ti shtoheshin atelierë të tjerë si tekstili, skenografia, grafika, qeramika, qelqi. Disa prej këtyre mediumeve në vitet '60 ishin dhënë vetëm si lëndë plotësuese, ndërsa formati i tyre si atelier do të përbënte strukturën e Fakultetit i Arteve Figurative deri në fund vitet '80. Staf i lëndëve artistike fillimisht përbëhej nga Danish Jukniu, Sali Shijaku, Andrea Mano, Kristaq Rama dhe Shaban Hadëri, Pandi Mele, Vasil Konomi, Ismail Lulani, ndërsa lëndët teorike zhvilloheshin nga Agim Duhanxhiu histori arti, Petro Papadhopulli anatomi, Maks Velo deskriptive (perspektivë) dhe disa specialistë mbi zejet. Ky staf padyshim do ndryshonte shumë në vitet në vazhdim, si për lëndët artistike dhe për ato teorike.

Ndryshime të rëndësishme ndoqi dhe vetë godina. Fillimisht Instituti i Arteve Figurative kish qenë në një godinë në rrugën e Kavajës, më pas në rrugën e Elbasanit, tek shkolla Mihal Grameno, për tu vendosur përfundimisht në vitin 1966 në godinën historike tek Sheshi "Nënë Tereza". Në mes vitet '60 u ngritën dhe atelier më profesionale në godinat e reja të projektuara nga arkitekti Mauricio Bega. Mbi këtë Dilo shton se: "... u shtuan atelierët e mëdhenj, me dritë nga veriu, si tekstili, grafika, piktura monumentale me pikturën murale e mozaikë, piktura, qelqi, xhami. Të gjithë atelierët i pajisëm me dollapë të varur në mur, ku çdo student kishte çelësin e vet. Plani ishte të shtoheshin. Donim të hapnim edhe një hapsirë për modën, sepse atëherë kishte dhe industri të tilla që mund të aplikoheshin dhe të ndikonin në jetën e përditshme."

Të diplomuarit e parë në sistemin tre vjeçar, të Institutit të Lartë të Arteve figurative në vitin 1963-64 ju nënshtruan një programi bazik lëndësh me orientim të qartë politik. Si të tilla, lëndët teorike ishin: Histori e Lëvizjes Komuniste, Histori e Popullit Shqiptar, Histori Arti, Materializmi Dialektik, Materializmi historik, Estetikë, Pedagogji, Ekonomi politike, Gjuhë Ruse. Ndërkohë pjesën dërrmuese të orëve mësimore e zinin lëndët profesionale, njohur si atelier. Ato ishin: Pikturë – Skulpturë, Kompozim, Vizatim, Perspektivë, Anatomi, Teknologji. Në fund i shtoheshin dhe ato plotësuese: Lëndë ushtarake dhe edukim fizik. E gjitha përmbylej me një Provim shteti dhe Mbrojtjen e Diplomës. Me 19 të diplomuar, të gjithë djem, Instituti i Lartë i Arteve Figurative do niste me prioritet të furnizonte me kuadro institucionet e arsimit dhe kulturës në vend. Në vitet në vazhdim do regjistroheshin dhe studentet e para femra, (mesatarja 1-2 për kurs) sdq, tendencë që do vinte gjithnjë në rritje.

Prej vitit akademik 1965 me sistemin e ri katërvjeçar, do të ndryshonte dhe numëri i të regjistruarve,

20 Intervistë me Ksenofon Dilon mbi Institutin e Lartë të Arteve / Intervistoi Prof. Najada Hamza

prej 10 studentësh për pikturë dhe 5 për skulpturë, (në vitin 1967 - '68 në total do të ishin 20 studentë) shifër e cila përcaktohej nga një planifikim shtetëror. Bashkë me to do të ndryshonte dhe sistemi i vlerësimit, nga ai i vjetri ku nota 2 ishte pakalueshëm, në vlerësimin maksimal me notën 5; në modelin e ri në minimumi 4 dhe maksimumi 10.

Prej vitit akademik '66 – 67 do të shtoheshin artet e aplikuara dhe lëndë të reja si pllakat, akuarel, stil shkronjash, teori drame, letërsi, etj. Në dhjetor të vitit 1969 do të miratohej Reforma Kombëtare për Arsim, e cila kërkonte tashmë në gjithë nivelet e arsimit “rishikimin e dokumentacionit shkollor, planet dhe programet duke i çuar ato drejt një politizimi të skajshëm. Tani i gjithë procesi mësimor dhe edukativ, programet dhe lëndët mësimore do të përshkoheshin nga ideologjia komuniste. Në kuadër të reformës u përpilua dhe një strukturë e re e shkollës. Mbi bazë të saj, sistemi arsimor do të mbështetej në tri komponentë: mësim - punë prodhuese - edukim fizik e ushtarak dhe do të përshkohej nga boshti ideologjik marksist leninist.”²¹

Përfundime

Historia e institucioneve artistike shqiptare, në esencë është pasqyrë e asaj dinamike të fortë që përshkoi një vend në ndërtim e sipër. Ajo u zhvillua paralelisht në gjithë formatet e mundëshme, duke u përshtatur me atë realitet që gjeti. Fillimisht nga një grup intelektualësh të huaj, si Polarolli e Ridola, e më pas nga intelektualët vendas të diplomuar në Perëndim, a Lindje. Ndryshimet më të mëdha ajo i përjetoi në formatin e vet universitar, kur projektimi i ndërtimit klasik akademik i la vendin dukshëm një orientimi politik. E gjithë kjo padyshim nuk mund të ishte pre e vullnetit e personaliteteve artistik të kohës, sesa nënshtrimi pa kushte e linjës ideologjike që kishte marrë vendi pas Luftës së Dytë Botërore.

Si e tillë kjo histori institucionale me gjithë ngjyrat dhe kërkësinë e vet, nuk është gjë tjetër veçse një histori tjetër e shekullit XX. Ajo padyshim përtheu gjithë vullnetet, apo ambiciet e një brezi intelektualësh për një atmosferë artistike të çliruar nga vullneti politik, duke u shndërruar në një mënyrë apo tjetër në një instrument për implementimin e vetë pushtetit.

Referenca

1. - Andon Kuqali, Historia e Artit Shqiptar 2, (Tiranë: ILA, 1989).
2. - Albert Xholi, “Thanas Papa: Drama me ish-gruan ruse pas 32-vitesh”, parë më 12 dhjetor 2014 në http://www.zemrashqiptare.net/news/id_29248/Thanas-Papa:-Drama-me-ish-gruan-ruse-pas-32-vitesh.html
3. - ASHSH, Historia e Popullit shqiptar IV, (Tiranë: Toena, 2008). 289
4. - Edward Lear, Edward Lear në Shqipëri, Ditar udhëtimesh, 1848-1849, (Tiranë: Plejad, 2008)
5. - Enver Hoxha, Mbi letërsinë dhe artet, (Tiranë: 1977).
6. - Genti Gjikota, Architectural stalinist typologies in albania – The palace of Culture and Cine-studio “New Albania”. (Ma... Bartlett School of Architecture, University College, London, 2009-2012), 29.
7. - Suzana Varvarica Kuka, Kristaq Rama – Monografi, (Tiranë: Zenit edition, 2004), 16,

²¹ ASHSH, *Historia e Popullit shqiptar IV*, (Tiranë: Toena, 2008). 289

8. - Odise Paskali, “Varfëria kreative e brezit të ri”, Illyria, nr. 3, 18 mars (1934).
9. - “Inaugurimi i ekspozitës s’artit”, Gazeta e Korçës, 8 qershor, (1932): 4.
10. - N. V. “Akademia e jonë e arthme e arteve të bukure”, Minerva, nr. 12-13, korrik – gusht, (1933): 18.
11. - Nebil Çika, “Një djep i jetës artistike në Shqipri”, Minerva, nr. 10, 15 maj, (1933): 12-14.
12. - “Shkolla përgatitore për artet e bukura”, Besa, 1 dhjetor (1932): 3.
13. - Lec Zadeja, “Zef Dajçi, mjeshtër i shquar i daltës e i allçisë”, Shkodra në shekuj, Seminar Ndërkombëtar, Vëllimi i II, (1999): 411.
14. - Simon Rrota, Po shkruaj për vedi e Shkodrën, (Shkodër: Botime Fishta, 2018), 91.
15. Intervista me Vilson Kilicën dhe Edi Hilën (arkiv i autorit) si dhe me Ksenofon Dilon mbi Institutin e Lartë të Arteve bashkë Prof. Najada Hamzën